

Q.K. 17



**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQERISE "BUFFET ALL'ITALIANA " sh.p.k.**

Ne Tirane, sot me date 19 Mars (dymije e tetembedhjete), bazuar ne ligjin nr 9901 dt 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe shoqerite Tregtare" ortaket :

**Z.Sokol Daka** , atesia Hysen ,shtetas shqiptar, dtl. 03.08.1985, lindur dhe banues ne Tirane , i paisur me e pasaporen me nr.personal: I50803067M, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar.....

**Znj.Valentina Peretti**, atesia Marko , shtatase Italiane , me datelindje 20.11.1985 ,lindur në Lugo(RA) dhe banuese në Ravenna,Itali , e pajisur me Letërnjoftim ID me Nr CA22811AH.

Te cilet me vullnet të lire të plote e të sinqerte, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise, ne Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, " Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare " te ndryshuar me ligjin 129/2014, ne ligjin 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", ne Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, krijojne Shoqerine Tregtare,me Pergjegjesi të Kufizuar, me emertimin "**BUFFET ALL'ITALIANA "** sh.p.k.

KREU I  
Emertimi, Forma Juridike, Selia, Kohezgjatja,Objekti.

Neni 1  
Emertimi

Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është "**BUFFET ALL'ITALIANA "** sh.p.k.

Neni 2  
Forma Juridike

Shoqeria "**BUFFET ALL'ITALIANA "** sh.p.k eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqeria"), e themeluar nga personat fizikë, te siperpermendur, të cilët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributet e ortakeve perbejne, kapitalin e regjistruar te shoqerise. Secili ortak gëzon kuotën e tij në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që ka dhënë në kapital. Çdo ortak zoteron nje kuote te vetme ne shoqeri. Çdo ortak ka te drejta vote ne perpjesetim me vleren nominale te kuotes se tij.

VALENTINA PERETTI  
Val Peretti

SOKOL DAKA  
Sokol Daka

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendren Kombetare të Biznesit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

### Neni 3

#### Selia

Shoqeria do t'ja ketë selinë në adresën: Yzberish, Tirane, z.k.3866, nr i pasurisë: 367/1/4+1-N2, vol.71, faqe 195.

Shoqeria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra perfaqësie, dege, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

### Neni 4

#### Objekti

- Bar-Restorant, Shitje me pakice e shumice e artikujve të ndryshëm ushqimorë e industriale. Import eksport, tregti me shumice e pakice të lendeve të para dhe mallrave produkt i gatshëm në përgjithësi, pije alkoolike dhe joalkoolike, duhan cigare, industriale të të gjitha llojeve, etj,
- Import-Eksport të paisjeve të guzhinës, mobilimet si dhe çdo lloj produkti nga të gjitha vendet e botes përfshirë dhe tregtim të tyre.
- transport mallrash tokësor dhe detar për vetë dhe për të tretë; si dhe çdo aktivitet tjetër i cili nuk bindet me legjislacionin shqiptar në fuqi.
- Shoqeria mund të bashkëpunojë edhe me shoqëri të tjera me të njëjtin objekt të njëjte ose të ndryshëm nga i saj, si dhe çdo aktivitet tjetër i cili nuk bindet me legjislacionin shqiptar në fuqi.

### Neni 5

#### Kohezgjatja

Shoqeria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit në QKB.

### KREU II

#### KAPITALI

### Neni 6

#### Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 10.000,00 lekë (dhjetë mijë leke), i përbërë nga 2 (dy) kuota.

Kapitali i shoqërisë është nënshkruar dhe shlyer teresisht nga ortakët e shoqërisë perkatesisht:

- Z. Z. Sokol Daka, zotëues të 1 kuote, me vlerë 5.000,00 leke, që përfaqëson me

VALENTINA PERETTI

Vd. Peretti

SOKOL DAKA

Sokol Daka

8

50,00% te kuotave te kapitalit.

- Znj.Valentina Peretti, zoterues te 1 kuote, me vlere 5.000,00 leke, qe perfaqeson me 50,00% te kuotave te kapitalit.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/ të paluajtshme apo të drejta).

#### Neni 7

##### Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund

të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;

d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Ky statut kushtëzon kalimin e kuotave te treteve jashte shoqerise, me miratimin e shoqërisë dhe të drejtën e parablerjes në favor të ortakëve të tjerë të shoqërisë, sipas modaliteteve dhe shumices se cilesuar qe kërkon ndryshimi i statutit.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te saj ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

#### KREU III

##### ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

#### Neni 8

##### Organi Vendimmarres

Asambleja e pergjithshme eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne kete statut dhe ne ligj.

Asambleja e pergjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të

kësaj pike;

dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;

VALENTINA PERETTI

Vdh Peretti

SOKOL DAIHA  
Sokol Daiha

10

e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;

ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;

f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;

g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;

gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;

h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblesë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamblesë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

#### Neni 9

#### Administrimi

Shoqeria do të administrohet nga nje administrator .

Administrator i shoqerise eshte Z.Sokol Daka , atesia Hysen ,shtetas shqiptar, dtl. 03.08.1985, lindur dhe banues ne Tirane , i paisur me e pasaporen me nr.personal: 150803067M, i cili do te ushtroje detyrat e administrimit te shoqerise per nje periudhe 5 vjecare me te drejte ripertitje.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti, apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë.

Administratori mund të heqë dorë në çdo kohë nga detyra e tij, nëpërmjet një njoftimi me shkrim drejtuar asamblesë së përgjithshme. Administratori, që jep dorëheqjen, duke pasur parasysh rrethanat e veprimtarisë së shoqërisë, është gjithashtu i detyruar të thërrasë asamblesë e përgjithshme për emërimin e administratorit të ri, përpara datës në të cilën dorëheqja të hyjë në fuqi.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk vendos emërimin e administratorit të ri në datën e përcaktuar në thirrjen e kryer nga administratori i dorëhequr, atëherë administratori i njofton me shkrim dorëheqjen Qendrës Kombëtare të Bizznesit , së bashku me kopjen e thirrjes së mbledhjes së asamblesë së përgjithshme dhe Qendra Kombëtare e Biznesit regjistron largimin e administratorit, sipas procedurave të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit", të ndryshuar.

Dorëheqja e administratorit nuk cenon paditë e shoqërisë për shkelje të detyrimit të besnikërisë që administratori ka ndaj saj, sipas këtij ligji".

Përveç kësaj, administratori shkarkohet nga gjykata për shkelje të ligjit me kërkesë të çdonjërit prej ortakëve.

Tagrat e përfaqësimit të administratorit dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Emërimi i administratorit prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Administrator i shoqerise mund te emerohet edhe nje person jashte ortakerise.

VALENTINA PEREPI

Vol Pakt

SOKOL DAKA  
sokol daka

## Neni 10

### Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) te kryejë të gjitha veprimet e administrimit te zakonshem të veprimtarisë tregtare së shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e pergjithshme,
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatiti dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojë përpara ortakeve në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

4. Në rastet e parashikuara nga pikat 3 e 5 të nenit 82 të këtij ligji, administratorët janë të detyruar të thërrasin asamblenë e përgjithshme.

5. Nëse mbledhja e ortakeve emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë. Statuti ose rregulloret e tjera, të miratuara mund të parashikojnë ndryshe.

Administratori përfaqëson shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve, bankat e te gjitha niveleve, zyrat e tatim taksave, doganave, zyrave te qeverisjes vendore etj.

Administratori nuk ka te drejte te nenshkruaje kontrata shitblerje pasuri te luajtshme dhe te paluajtshme, kontrata qeraje, kontrata huaje, hipoteke, pa marre me pare miratimin me shkrim te asamblese se ortakeve.

## Neni 11

### Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

## Neni 12

### Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit 9901 date 14.04.2008

VALENTINA PENETI

Vol Peneti

SOLLU DAKA  
Sohal Sohe

8

"Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare" ndryshuar me ligjin 129/2014, Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 13

Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarreveshje që mund të lindin midis Shoqërisë dhe të tjerëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare sipas dispozitave të Kodit Civil.

Neni 14

Dispozita perfundimtare

Autorizohet Z.Sokol Daka, atesia Hysen, shtetas shqiptar, dtl. 03.08.1985, lindur dhe banues në Tiranë, i paisur me e pasaporen me nr.personal: 150803067M, të depozitojë këtë akt themelimi dhe statutin e shoqërisë, pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, si dhe të ndjekë të gjitha procedurat ligjore për regjistrimin e shoqërisë.

Ky akt themelimi u redaktua në 4 ekzemplare me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike, në gjuhën shqipe dhe në gjuhën italiane dhe miratohet në parim dhe nën nën nga Ortaket themelues të shoqërisë tregtare "BUFFET ALL'ITALIANA" sh.p.k, në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën orgjinale .

ORTAKET

Valentina Peretti

VALENTINA PERETTI

Sokol Daka

SOKOL DAKA

Publika / Tradotto  
Dante M. L.

WILIA BERBERI  
TRADUTTORE GIURATO  
INCORPORATO PRESSO IL  
MINISTERO DELLA GIUSTIZIA  
CIVILIA IN ITALIA PER IL  
N. 1335 842058937

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTERISE TIRANE  
Nr. 87 Rep.



NOTERE  
Marsela Q. Elmazaj  
NO. 11. 31901010 J  
KALLI I DOLLËS U PAG.

### VERTETIM NENSHKRIMI

Ne Tirane, sot me date 19 Mars 2018(dymije e tetembdhjete) perpara meje noteres Marsela Elmazaj me adrese ne Tirane , Bulevardi Bajram Curri, anetare e Dhomes se Noterise Tirane, u paraqiten personalisht:

Z.Sokol Daka, atesia Hysen ,shtetas shqiptar, dtl. 03.08.1985, lindur dhe banues ne Tirane , i pajisur me e pasaporen me nr.personal: I50803067M, madhor dhe me zotesi te plote nendike per te vepruar.....

Znj.Valentina Peretti, atesia Marko , shtatase Italiane , me datelindje 20.11.1985, lindur në Lugo(RA) dhe banuese në Ravenna,Itali , e pajisur me Letërnjoftim ID me Nr CA22811AH, Te cilet me vullnetin e tyre të lire, të plote dhe të singerte, me cilesine e ortakeve themelues te shoqerise "BUFFET ALL'ITALIANA " sh.p.k kane redaktuar ne gjuhen shqipe dhe Italiane , Akt -Themelimin sa me siper dhe pasi e lexuan dhe e kuptuan, e nenshkruan pa verejtje duke shkruar emrin mbiemrin dhe firmen e tyre orgjinale ne kete zyre para meje Noteres.

Une Noterja vertetoj rregullsine dhe bazueshmerine e redaktimit ne ligj te ketij akti si dhe autenticitetin e nenshkrimeve, me cilesine qe me nje neni 55 i Ligjit nr. 7829, date 01.06.1994. " Per Noterin " ne Republiken e Shqiperise.

NOTERE  
Marsela Elmazaj